

## SKEMA E GRANTEVE 'ALTERNATIVE PATHWAYS' LOT 2

### Grante për aksione komunitare dhe aktivizimin e të rinjve

LOTI 2 do të kontribuojë në rezultatin e programit: *Të rinj të ndryshëm angazhohen me shoqërinë civile dhe ndërmarrin veprime proaktive në komunitet për të sjellë ndryshim.*

**Objektivi specifik** është të mundësojë dhe fuqizojë organizatat lokale dhe grupet joformale me bazë komunitare, për të mobilizuar dhe përfshirë të rinjtë, në identifikimin e problemeve dhe sfidave, dhe për të propozuar, planifikuar dhe zbatuar aksione lokale që mund të sjellin ndryshim në komunitet.

### Aktivitetet e propozuara

Një projekt propozim mund të përfshijë një ose më shumë nga sa vijon:

- Hartimi dhe zbatimi i **nismave komunitare** me pjesëmarrje të të rinjve, për të adresuar sfidat social-ekonomike dhe kulturore të komuniteteve (fokus i veçantë të të rinjtë), duke nxitur angazhimin qytetar dhe advokimin: Rritjen e ndërgjegjësimit, propozimin e zgjidhjeve, aksion konkret dhe advokim, duke përfshirë aktorë të ndryshëm: shkolla, shoqëria civile, aktivistë, media, këshillat rinorë vendorë, etj.
- **Mikro financim** për aksione komunitare nga grupime joformale të qytetarëve të angazhuar, shoqëruar me mentorim dhe rritje kapacitetesh
- **Përdorimi** i metodologjisë së **Aktivizmit Kreativ** duke bashkuar aktivistë të rinj me artistë të rinj (të rinj me talent artistik dhe/ose artistë profesionistë), për të bashkëpunuar, vepruar dhe advokuar për një çështje me interes të përbashkët për komunitetet e tyre, duke përdorur artin dhe kreativitetin për të maksimizuar impaktin. Kjo mund të përfshijë:
  - Trajnime/zhvillim i kapaciteteve mbi metodologjinë
  - Nisma/permanca/fushata/inisiativa advokuese konkrete lokale
- **Shkolla/kampe verore lokale** që mund të kombinojnë:
  - *Zhvillimi i aftësive dhe njohurive për të rinjtë*
  - *Konkurs idesh për nisma/miniprojekte në komunitet*
  - *Fushata Kreative*
  - *Prodhime multimediale*
  - *Ekspozita dhe shfaqje artistike*
  - *Inisiativa Hackathon/Datathon*
  - *Folës të ftuar, interpretues të njohur, etj.*

- *Eksplorim dhe/ose zhvillimi i rrugëve 'hiking'*
- *Panaire dhe konkurse lokale (punime artizanale, produkte digitale, video dhe film, ide sipermarrje dhe start up, etj.)*
- *Inisiativa të lidhura me trashëgiminë kulturore dhe/ose turizmin lokal*
- *Etj.*
- **Inisiativa bashkëpunuese** mes komuniteteve aktive dhe **këshillave rinore vendorë** për të advokuar në këshillat bashkiakë, duke përdorur instrumentat demokratike për angazhim e pjesëmarrjes në vendimarrje, të parapara edhe në Ligjin për vetëqeverisjen vendore, për të ndikuar në vendimmarrjen lokale për tema të rëndësishme për komunitete specifike, me fokus kryesisht të rinjtë
- Ofrim programesh për **Mentorim të të Rinjve**
- Ofrim mundësish për **Internshipe për të rinjte (ne OJQ, biznes, media)**
- **Panaire tematike joformale për të rinj dhe fëmijë:** p.sh. panairë të ideve të biznesit të të rinjve/fëmijëve për të inkurajuar dhe promovuar aftësitë sipërmarrëse, etj.
- Nisma të tjera komunitare

## Kush mund të aplikojë

### Aplikantët e mundshëm mund të jenë:

- OJQ-të, Organizata me bazë komunitare lokale, etj. që dëshirojnë të ndërmarrin aksione për të adresuar çështje me interes publik, ndërkohë që zhvillojnë aftësi të reja dhe promovojnë të rinj të talentuar dhe aktivë në komunitet
- Nëse organizata aplikuese nuk është nga zona e veriut, atëherë partneriteti me organizata lokale nga zona e veriut dhe/ose grupe joformale lokale është një **kërkesë e detyrueshme**
- Partneritetet lokale inkurajohen në të gjitha rastet

## Buxheti

Minimumi 7,000 GBP; Maksimumi 30,000 GBP

Varësisht nga numri i bashkive që do të mbulohen, tipologjia e aplikantit (kapaciteti zbatues), dhe shkallës së ndërhyrjes, buxheti mund të ndryshojë ndërmjet intervalit të paracaktuar të mësipërm.

Lejohet nën-grantimi (si për organizatat më të vogla lokale ashtu edhe për individët).